



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202000325/2

Tiranë ___/___/2020

Lënda: *Rekomandim për garantimin e të drejtave të personave të moshuar, të cilët janë të akomoduar në Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë.*

Drejtuar: **Znj. Luneda SUFALI**
Drejtoreshë e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror

TIRANË

Për dijeni: **Znj. Anila PEÇI**
Drejtoreshë e Shtëpisë së të Moshuarve

TIRANË

E nderuara zonja SUFALI,

Në ushtrimin e mandatit të tij kushtetues në promovimin, parandalimin e shkeljes dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të ligjshme të individëve, nga veprimet e paligjshme dhe të parregullta të administratës publike dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj, Avokati i Popullit ka si prioritet të tij, promovimin dhe garantimin e të drejtave të personave të moshuar.

Aktiviteti ynë është shtrirë në disa aspekte konkrete të mbrojtjes së këtyre personave, me një qasje proaktive dhe të dedikuar, duke zhvilluar në mënyrë të vazhdueshme me iniciativë, inspektime në Shtëpitë e të Moshuarve në të gjithë vendin.

Një nga këto inspektime është zhvilluar nga përfaqësues të Institucionit të Avokatit të Popullit, më datë 26.02.2019, në Shtëpinë e të Moshuarve, Tiranë.

Avokati i Popullit, pasi shqyrtoi informacionin nga monitorimi i realizuar, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor, t'Ju parashtrojë përfundimet e këtij monitorimi, si më poshtë vijon.

Objektivat e inspektimit:

- Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga Avokati i Popullit në vitin 2017 si dhe gjendja aktuale,
- Vlerësimi i dokumentacionit, procedurave dhe personelit, në zbatim të legjislacionit në fuqi,
- Respektimi i të drejtave të personave të moshuar, të cilët janë akomoduar në këtë institucion rezidencial, në zbatim të standardeve ligjore, të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për të moshuarit.

Metodologjia

Grupi i inspektimit i institucionit të Avokatit të Popullit, i përbërë nga juristë, si metodologji pune ka përdorur:

- ***Së pari***, zhvillimin e bisedave paraprake me përgjegjësen e sektorit social, informacion, i cili është hedhur në një formular standard për inspektimin.
- ***Së dyti***, monitorimin e zbatimit të standardeve ligjore të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për qendrat rezidenciale për të moshuarit.
- ***Së treti***, monitorimin e mjediseve dhe kushteve të institucionit (Shtëpia e të Moshuarve, Tiranë), ku ofrohen shërbime për personat e moshuar.
- ***Së katërti***, komunikimi me disa të moshuar, përfitues të shërbimeve të përkujdesjes, të akomoduar në Shtëpinë e të Moshuarve, Tiranë.

Rekomandimet e vitit 2017 dhe niveli i zbatimit të tyre

Nga inspektimi i kryer më datë 07.12.2017 në Shtëpinë e të Moshuarve në Tiranë, pas problemeve të konstatuara, ju jemi drejtuar me rekomandime për marrjen e masave për:

1. *Shtim në organikë me: infermierë, roje objekti, psikiatër.*
2. *Gjetjen e mundësive për vendosjen e një automjeti.*
3. *Të shihet mundësia, që brenda buxhetit të këtij institucioni, zhvillimi i aktiviteteve të jetë si “zë” më vehte.*
4. *Sistemimin e të moshuarve, të cilët janë me probleme të rënda shëndetësore në një qendër të përshtashme për ta.*

Në përgjigje të rekomandimeve të sipërcituara, na u kthye përgjigja e mëposhtme:

- *Për rekomandimin nr.1, është e drejtë e institucionit të kryejë prokurimin e shërbimit me roje objekti. Për shtesë në organikë me infermierë e psikiatër, Shërbimi Social Shtetëror do të bëjë vlerësimin e stafit në raport me përfituesit për të dalë në konkluzione konkrete për të propozuar mbi përmirësimet e organikës me figurat e duhura.*

- *Për rekomandimin nr.2, nuk ka makina dhe shofer në organikë, në zbatim të ligjit nr. 10160 datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nënpunësit civilë”.*

- *Për rekomandimin nr.3, zhvillimi i aktiviteteve si ‘zë’ më vete, thesari nuk e lejon përdorimin e fondeve për kryerjen e aktiviteteve në institucion.*

- *Për rekomandimin nr.4, përsa i përket të moshuarve me probleme të rënda shëndetësore, institucionet për të moshuarit kanë infrastrukturën e duhur për të trajtuar rastet. Moshja e tretë ka probleme të shëndetit dhe trajtohen si brenda nga mjeku dhe stafi social dhe jashtë institucionit në Poliklinikën e lagjes ku kanë të hapura kartelat apo në spital sipas diagnozave specifike që ata kanë.*

Lidhur me zbatimin e rekomandimeve, rezultoi se:

- *Rekomandimi për shtim në organikë me infermierë, roje objekti, psikiatër, ishte realizuar pjesërisht. Janë shtuar 4 punonjës, të cilët punojnë me kohë të pjesshme: 1 (një) ndihmës/kuzhinierë dhe 3 (tre) kujdestare. Këta punonjës punojnë me turne, sipas grafikut.*

- *Rekomandimi për vendosjen e një automjeti, nuk është realizuar. Institucioni ka lidhur një kontratë me shërbimin “Taxi”, për çdo eventualitet.*

- Rekomandimi për mundësinë, që brenda buxhetit të këtij institucioni, të zhvillohen aktivitetet e jetë si “zë” më vehte, ende nuk është realizuar, por po ndërmjetësohet për këtë proces me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

- Rekomandimi për sistemimin e të moshuarve, të cilët janë me probleme të rënda shëndetësore, në një qendër të përshtatëshme për ta, nuk është realizuar. Këta të moshuar, vizitohen nga mjeku psikiatër i Qendrës Shëndetësore.

Gjendja aktuale

-Profili i Shtëpisë së të Moshuarve, Tiranë

Shtëpia e të Moshuarve Tiranë, është një qendër rezidenciale, ku trajtohen persona, të cilët kanë mbushur moshën për pension pleqërie, sipas legjislacionit në fuqi.

Ky institucion është nën administrimin e Shërbimit Social Shtetëror. Mbështetja financiare është e garantuar nga fondet e buxhetit të shtetit, nga programet e mbrojtjes sociale të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nëpërmjet Shërbimit Social Shtetëror. Është përgjegjëse për mbarëvajtjen e punës dhe raporton për problematika të ndryshme pranë Shërbimit Social Shtetëror.

Shtëpia e të Moshuarve, Tiranë, ofron shërbime sipas standardeve të miratuara për personat e moshuar, të cilët janë të vetmuar dhe të braktisur, sipas verifikimeve të kryera nga punonjësi social në njësinë e qeverisjes vendore për vlerësimin dhe referimin e rastit dhe që kanë nevojë për kujdes të vazhdueshëm.

Organizimi dhe funksionimi i këtij institucioni, së bashku me përshkrimet e punës, të drejtat dhe detyrimet e përfituesve, janë të parashikuara në Rregulloren e Brendëshme të tij, e cila është e afishuar në ambjentet e institucionit.

Zbatimi i standardeve të ofruara të shërbimeve sociale, si një proces vazhdueshëm, monitorohet nga Shërbimi Social Shtetëror, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Tiranë; nga inspektimet e kryera të Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Institutit të Higjienës, Agjensisë Kombëtare të Ushqimit etj.

-Numri i përfituesve nga shërbimet e ofruara

Nga konstatimi paraprak u evidentua se, në këtë Shtëpi të Moshuarish mund të akomodohen dhe ofrohen shërbime për persona të moshuar, mbi moshën 60 vjeç për femra dhe 65 vjeç për meshkuj.

Kapaciteti i institucionit për ofrimin e shërbimeve është për 50 persona të moshuar.

Gjatë inspektimit u konstatua se në të trajtoheshin 45 të moshuar, nga të cilët 15 të moshuar me probleme të rënda shëndetësore, të paafte fizikisht dhe me probleme të shëndetit mendor, të cilët kërkojnë kujdes të veçantë.

Përfitues të pensionit të pleqërisë janë 44 të moshuar, të cilët nuk paraqitën ankesa ndaj stafit për këtë shërbim.

Për çdo përfitues të shërbimeve të këtij institucioni ishte hartuar një plan kujdesit shëndetësor, sipas nevojave të tyre specifike. Kartelat mjekësore individuale mbahen nga mjeku i familjes, i cili është psikiatër dhe punon me kohë të pjesshme në këtë institucion.

Një pjesë e medikamenteve me të cilat trajtoheshin të moshuarit ishin të rimbursueshme dhe nuk kishte probleme me marrjen e tyre, ndërsa pjesa tjetër e medikamenteve që nuk ishin të rimbursueshme, mbuloheshin me fondet e vetë institucionit.

-Burimet njerëzore

Struktura e përcaktuar e personelit të këtij institucioni rezidencial përbëhet nga 15 punonjës me kohë të plotë si dhe 8 (tetë) punonjës me kohë të pjesshme: 1(një) mjek, 1(një) sanitare, 1(një) ndihmës/kuzhinierë dhe 5(pesë) kujdestarë.

Gjatë turnit të parë punojnë 2(dy) sanitare, 1(një) kujdestare (infermiere) dhe 1(një) sanitare, e cila punon me kohë të pjesshme.

Gjatë turnit të dytë punojnë vetëm 2 (dy) kujdestare

Gjatë turnit të tretë vetëm disa ditë arrihet që puna të mbulohet me 2 (dy) kujdestare.

Me trajtimin e problemeve psiko-sociale, të përfituesve të shërbimeve të ofruara është e ngarkuar 1(një) punonjëse sociale, 1 (një) psikologe dhe mjeku psikiatër.

Shërbimet shoqërore ofrohen nga 7 kujdestarë, nga të cilët 3 (tre) janë infermiere dhe 1 (një) punonjës, i cili është i është ngarkuar detyra e magazinierit.

Shërbimi dentar realizohet individualisht, nga vetë të moshuarit, me shpenzimet e tyre dhe jo me fondet e institucionit.

Vlerësimi i punës së stafit bëhet 2 herë në vit nga drejtuesja e institucionit. Trajnimet janë bërë nga vetë stafi për tematika të ndryshme dhe për përmirësimin e mëtejshëm të punës. Gjithashtu 3 (tre) kujdestarë ishin të trajnuar nga Kryqi i Kuq Shqiptar.

Megjithatë nga konstatimet e kryera gjatë inspektimit, gjykojmë se numri i punonjësve që ofrojnë shërbime shoqërore në këtë qendër është i pamjaftueshëm, ndaj edhe nevojitet shtimi i këtij numri me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimeve sociale për personat e moshuar.

-Ambjentet e Shtëpisë së të Moshuarve, Tiranë

Shtëpia e të Moshuarve në Tiranë ndodhet në një godinë tre katëshe. Në katin e parë të kësaj godine gjenden dhomat, ku ishin sistemuar të moshuar me probleme shëndetësore dhe menca. Në katin e dytë gjenden disa dhoma fjetjeje për të moshuarit. Në katin e tretë gjenden dhoma të tjera fjetjeje për të moshuarit, zyrat e administratës, salla e aktiviteteve. Tualetet dhe dushet, ishin të përshtatura për përfituesit e këtij institucioni.

Ambjentet e këtij institucioni ishin në kushte shumë të mira, të arduara dhe komode për të moshuarit.

Në një ambient të veçantë ishin të afishuara rregulloret e jetës së brendshme, standardet që duhet të respektojnë punonjësit e këtij institucioni, si dhe ishte vendosur edhe “*kutia e ankesave*”, ku depozitoheshin ankesat e të moshuarve.

“*Kutia e ankesave*” hapej një herë në muaj, nga përfaqësuesi i Shërbimit Social Shtetëror në praninë e një të moshuari.

Mjetet për shmangien e rreziqeve që mund të vijnë nga rastet e emergjencave civile, ishin të vendosura në vende të veçanta në korridore. Kolaudimi i tyre bëhet 1 herë në vit. Stafit ishte trajnuar për përdorimin e mjeteve kundër zjarrit.

Sistemi i ngrohjes dhe ftohjes realizohej me kaldajë, i cili funksiononte, duke e alternuar me kaloriferët, të cilët ishin të vendosur në çdo dhomë.

Sikurse e evidentuar gjatë inspektimit, nuk u paraqiten probleme për furnizimin me artikujt hotelerike. Ky furnizim përgjithësisht realizohej nga donacione të ndryshme, si dhe nga fondet e institucionit.

Ambjenti i kuzhinës ishte i pastër, i pajisur me soba profesionale, frigorifer etj. Kampionët e ushqimeve për të treja vaktet ruheshin në frigorifer.

Kuota ushqimore ishte rritur, nga 300 lekë në ditë në 360 lekë në ditë, e mjaftueshme për përfituesit, gjë e cila u konfirmua edhe nga vetë ata.

Për përcaktimin e menysë dhe oraret e vakteve të ngrënies, merrej mendimi i të moshuarve. Menuja javore firmoset nga një i moshuar, e cila mund edhe të ndryshohet po nga të moshuarit sipas preferencave. Një herë në vit plotësohet pyetësori për ndryshimin e menysë dhe merret mendimi i tyre.

-Jeta social-kulturore

Përsa i përket jetës sociale, nga informacioni që u mor gjatë inspektimit u konstatua se organizoheshin aktivitete të ndryshme: ditëlindje, festa fetare, festat zyrtare, etj.

Të moshuarit vizitohen nga të afërmit e tyre. Takimet e realizuara pasqyrohen në një regjster të veçantë. Për të moshuarit që nuk kanë kontakte me të afërm, bëhet një punë e madhe nga stafi për të bërë të mundur kontaktimin e tyre.

Në sallën e aktiviteteve, ishte e vendosur një bibliotekë, televizor, ku të moshuarit kalonin një pjesë të kohës në mënyrë të kulturuar.

Nga biseda e bërë me disa nga të moshuar të kësaj qendre, nga ana e tyre u shpreh mirënjohja dhe falenderimi për përkushtimin në punë të stafit të këtij institucioni.

Nuk u paraqitën ankesa ndaj stafit. Ata konfirmonin gatishmërinë e stafit për të plotësuar çdo kërkesë të tyre.

Çdo të enjte bëhet mbledhje me të moshuarit, ku shprehen shqetësimet dhe kërkesat e tyre.

Një tregues i dukshëm gjatë këtij inspektimi ishte përkushtimi i stafit ndaj përfituesve.

-Problematikat e konstatuara:

- Konstatohet se nuk ka kapacitete të mjaftueshme njerëzore, të domosdoshme për të ofruar shërbimet sipas standarteve të përkujdesit shoqëror. Pavarësisht shtimit të personelit me kujdestarë, rezulton se ato janë punësuar me kohë të pjesshme.
- Konstatohet se, krevatet ekzistues për kategorinë e të moshuarve me probleme të rënda shëndetësore në lëvizje, nuk janë të përshtatura në funksionalitet për këta përfitues. Ky fakt përbën burim për gjenerimin e vështirësive/problematikave konkrete jo vetëm për këtë kategori përfituesish, por edhe për stafin punonjës, i cili i shërben përfituesve të kësaj kategorie.
- Konstatohet se, dera kryesore në hyrje te këtij institucioni ishte hapur, pasi nuk ka roje objekti. Nuk ka fond buxhetor për ta përdorur për realizimin e këtij pozicioni pune. Gjatë ditës ky shërbim kryhet nga vetë të moshuarit, ndërsa gjatë orëve të natës kryhet nga vetë stafi.
- Konstatohet se për kryerjen e aktiviteteve të ndryshme jashtë institucionit, nuk ka fonde të mjaftueshme. Aktivitetet social-kulturore, zakonisht zhvillohen brenda institucionit.
- Konstatohet si një problematikë, që ende ka mbetur pa zgjidhje, mungesa e një automjeti, i cili është i rëndësishëm për transportin e të moshuarve. Aktualisht, siç jemi shprehur edhe më lart, ka një kontratë me shërbimin “taxi”, ku është lidhur një marrëveshje për t’i transportuar

të moshuarit në qendrat shëndetësore. Por çdo muaj ë moshuarit kanë vizitat e tyre mjekësore. Përpos kësaj vendosja e një automjeti është i rëndësishëm edhe për organizimin e aktiviteteve të ndryshme, jashtë institucionit dhe kjo kërkon shpenzime, të cilat me fondet e akorduara institucionit, janë të pamjaftueshme për realizimin e këtij shërbimi.

- Së fundmi, kontatohet se për stafin e punësuar në Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë, nuk ka patur trajnime nga Shërbimi Social Shtetëror dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Sa më sipër, në funksion të jetesës së tyre me dinjitet e në mënyrën më të mirë të mundshme, duke gëzuar plotësisht të drejtat e tyre themelore të sanksionuara në aktet ligjore e nënligjore; duke marrë në konsideratë konstatimet e renditura më sipër, Avokati i Popullit gjykon se pavarësisht punës rigoroze të bërë në këtë institucion, kërkohet një angazhim më i madh dhe një bashkëpunim më i mirë ndërinstitutional, për përmbushjen e standardeve të përkujdesit shoqëror për të moshuarit e akomoduar në Institucionet Rezidenciale.

Për këtë qëllim, për t'iu përgjigjur nevojave të tyre dhe për një jetesë sa më dinjitoze për të moshuarit në Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë,, në mbështetje të nenit 21, të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar

REKOMANDOJMË:

- Marrjen e masave përkatëse për shtim në organikë të pozicionit të punës me kujdestarë me kohë të plotë.
- Marrjen e masave për të shtim fondi buxhetor, me qëllim mundësimin e punësimit të rojes së objektit, të vendosjes së një automjeti si dhe për të mundësuar kryerjen e aktiviteteve të ndryshme për të moshuarit jashtë institucionit të Shtëpisë së të Moshuarve, Tiranë.
- Marrjen e masave për zëvendësimin e krevateve ekzistuese me krevate të përshtatura për 3 (tre) të moshuar me probleme të rënda shëndetësore në lëvizje, të cilët janë të akomoduar në katin e parë të këtij institucioni.
- Marrjen e masave për kryerjen e trajnimeve lidhur me zbatimin e standardeve shoqërore për stafin e Shtëpisë së të Moshuarve, Tiranë.
- Marrjen e masave për sistemimin e të moshuarve, të cilët janë me probleme të rënda shëndetësore në një qendër të përshtashme për ta.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar: “Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve tona, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të të moshuarve, lutemi shqyrtimin e rekomandimeve të sipërcituar.

K O M I S I O N E R

Vilma SHURDHA